



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Permanentni Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	04.07.2013
REFERENC-Ë:	12/1626/3-251/DMM
PËR/ZA/TO:	"Triagle General Contractors - INC" Branch Kosova, Prishtinë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim



Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, e ka shqyrtuar aplikacionin për Pëlqim Mjedisor të dërguar nga kompania e juaj me nr.prot.: 12/1626/3-251/DMM dhe ka vendosur si në vendimin e bashkangjitur të kësaj letërpërcjellëse.

Me respekt,

Faqe 1 nga 3



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Permanentni Sekretara / Office of the General Secretary

Në bazë të nenit 29.paragrafi 1, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025, nenit 21 paragrafi 4 të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 03/L-214 dhe nenit 90. të LPA (Nr.02/L-28), Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, bie këtë:

V E N D I M

Deklarohet i përfunduar procedimi administrativ i kërkesës për Pëlqim Mjedisor me nr.prot.:12/1626/3-251/DMM, kompanisë “Triagle General Contractors - INC” Branch Kosova, Prishtinë lidhur me ndërtimin e hidrocentraleve të vogla në Lumin Erenik.

A r s y e t i m

Kompania “Triagle General Contractors - INC” Branch Kosova, Prishtinë ka aplikuar për Pëlqim Mjedisor sipas kërkesës me nr. të protokollit:12/1626/1 lidhur me ndërtimin e Hidrocentraleve Mal, Erenik dhe Jasiq ne komunën e Junikut. Aplikacionit i është bashkangjitur Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe dokumentacioni tjetër përcjellës.

Në kuadër të shqyrtimit të dokumentacionit janë konstatuar faktet në vijim:

- Dokumentacioni i “ informatave shtesë” të dt. 14.02.2013 sipas kërkesës së MMPH /DMM me nr.12/1626/2 të datës 15. 10. 2012, nuk i përmbush të gjitha kushtet e parapara me legjislacionin ligjor në fuqi.

Faqe 2 nga 3

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave “ Rilindja” kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë

Telefon: + 381 38-200-32-307

<http://ëëë.ks-gov.net/mmph>, E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net



- Organi kompetent në kuadër të procedimit administrativ ka konstatuar mungesën e Kontratës që vërteton dhënien e pjesëve të ngastrave në shfrytëzim, nga Agjencia Pyjore e Kosovës.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor i ka ripërsëritur kërkesën për **informata shtesë** më datë: 25.03.2013, ku në bazë të nenit 78 të Ligji për Procedurën Administrative Nr.2005/02-L28 është përcaktuar afati ligjor, të cilin afat pala nuk e ka respektuar.

Dokumentacioni i lartë kërkuar është në përputhje me nenin 2 paragrafi 3 nënparagrafi 3.12 të U.A. nr.08/2012 për përcaktimin e dokumenteve për aplikacion për Pëlqim Mjedisor sipas llojit dhe natyrës së projekteve.

Bazuar në mangësit e dokumentacionit administrativ, dhe në pamundësin e marrjes së vendimit përfundimtar, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Shpjegim për palën: Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për riaplikim sipas procedurës së rregullt.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë në afat 30 ditësh nga dita e të të njejtit.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Nr.: 12/1626/4-ZSP/ *158*/13 datë:04.07.2013
Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. Inspektoratit
4. Kabinetit të Ministrit
5. Arkivit të MMPH-së

Arben CITAKU

Sekretar i Përgjithshëm



Faqe 3 nga 3